



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
 TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
 OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D.



# BULETINI

Nr. 19-20, Viti XV, 2022.

# PËRMBAJTJA

Votohet pro vazhimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E	3	KOSTT shenon 15 vjetorin e themelimit dhe gjashtë muaj nga pavarësia e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës	22
KOSTT kompani lidere në sektorin publik për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë	4	Vëhet nën tension linja e re e tensionit të lartë 110 kV që lidhë NS 220/110 kV Kosova A me NS 110/35/10 kV Lipjani	25
ALPEX nënshkroi marrëveshjen për implementimin e platformës elektronike të tregtimit	4	KOSTT fillon përgatitjet për investim kapital në ndërtimin e Nënstacionit të ri 110 kV në Ferizaj	26
Kompletohet struktura e Bordit të Drejtorëve të KOSTT me emërimin e Komisionit të Auditimit nga ana e aksionarit	5	KOSTT 1 vit zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri- Kosovë	26
Nënshkruhen Marrëveshje për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell	6	KOSTT vlerëson partneritetin e vazhdueshëm me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW	27
Avancimi dhe zhvillimi i të rinjve mbetet ndër prioritetet e KOSTT	7	Nënshkruhet Marrëveshja mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë	28
KOSTT promovon barazinë gjinore në vendin e punës	7	Menaxhmenti i KOSTT priti në takim delegacionin e Bankës Botërore	28
#KOSTT mundëson punë praktike për personat me Sindromën Down	9	Delegacioni nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe KfW vizituan KOSTT	29
Menaxhmenti i KOSTT realizoi takim me përfaqësuesit e Tetra Tech	9	Deklarata e Sekretarit Amerikan të Shtetit për integrimin e tregut të energjisë Shqipëri-Kosovë	30
KOSTT nënshkruan kontratë për ndërtim të nënstacionit të ri në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Komunën e Ferizajt	10	Kriza energjetike globale reflektoi edhe në situatën energjetike në vend	30
Përfaqësues të KFOR-it britanez vizituan KOSTT	10	KOSTT pjesë e panelit në punëtorinë me Rrjetin e Bizneseve për Energji të Pastër-N4CEB	31
Menaxhmenti i KOSTT priti në takim drejtorin e çështjeve politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës	11	Punonjësit e mirëmbajtjes së linjave të KOSTT ngjiten në shtyllën e akullit elektrike në 30 m lartësi	31
Bashkëpunimi i KOSTT dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë vazhdon	11	Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës shqyrtoi Raportin Vjetor të #KOSTT sh.a, për vitin 2021	32
Ambasadori i RF Gjermane në Kosovë priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT	12	Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit të Ambasadës Franceze dhe të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD)	32
Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ministrin e Ekonomisë znj. Artane Rizvanolli	13	U mbajt Dëgjimi publik për projektin e ndërtimit të linjës së kombinuar 110 kV në Komunën e Ferizajt	33
KOSTT vlerëson partneritetin e vazhdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës	14	U mbajt Mbledhja Komemorative në nderim të personalitetit dhe veprës së ekspertit të shquar të sektorit të energjisë Skender Gjonbalaj	33
KOSTT përfitues i grantit të USAID për avancimin e barazisë gjinore	14	Reflektimi i kostove të sistemit elektroenergjetik është domosdoshmëri për mbrojtjen e integritetit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës	34
Mbahet mbledhja e përgjithshme vjetore me përfaqësuesin e aksionarit	15	U mbajt Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin	35
U mbajt Forumi virtual "Roli i gruas në sektorin e energjisë - përvoja e KOSTT"	17	Prezantohet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e KOSTT për ndërtimin e Nënstacionit të ri GIS 110/35/10 (20) kV Fushë Kosovë	35
Inspirohu ne energji	20	KOSTT përshëndet nënshkrimin e Programit Kompakt në mes të Kosovës dhe SHBA , përfaqësuar nga MCC	36
Prezantohet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e KOSTT për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 me infrastrukturë përcjellëse	21	#NeJemiKOSTT	36
KOSTT mirëpret miratimin e Udhërrëfyesit për implementimin e Marrëveshjeve të Energjisë në mes të Kosovës dhe Serbisë	21		

## Buletini nr.19-20, Viti XV, 2022

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,  
Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383(0) 38 501 301 174;  
email: info@kostt.com  
Web: www.kostt.com

Buletini është publikim periodik i KOSTT sh.a  
i cili përgatitet nga  
Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun  
Për më shumë informacione ju lutemi kontaktoni në:  
zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com  
Publikuar në 2022

# Votohet pro vazhdimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E



Me këtë rast, U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Sabri Musiqi theksoi:

**“Ky është një lajm shumë i mirë për Kosovën. Falënderoj të gjitha OST-të e Evropës Kontinentale pjesëmarrëse në votim për përkrahjen. Ky besim nga homologët tanë evropian nuk është sinjal për relaksim por obligim i të gjithë akterëve të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës për të kontribuar në funksionimin e sistemit në përputhje me standardet e parapara teknike. KOSTT si palë kontraktuese me ENTSO-E është e përkushtuar në përmbushjen strikte të të gjitha obligimeve që dalin nga Marrëveshja dhe për të kontribuar në sigurinë e operimit të sistemit rajonal të energjisë elektrike, si detyrë primare e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit”**

Me 25 gusht 2022 u përmbyll me sukses votimi për vazhdimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE), trup i ENTSO-E.

Pas përfundimit të afatit dy vjeçar, vazhdimi i Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E u përkrah unanimisht nga ana e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Evropës Kontinentale, nënshkruese të marrëveshjes.

Me këtë, KOSTT (Kosova) vazhdon operimin e pavarur si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë, pjesë e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

Në bazë të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës/KOSTT përfundimisht u pavarësua nga Blloku SMM (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut) dhe më 14 dhjetor 2020 filloi operimin si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

Kjo Marrëveshje ishte një nga të arriturat his-

torike për shtetin e Kosovës dhe çelësi i progresit shumë-dimenzional për KOSTT dhe Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës në përgjithësi.

Nga dhjetori i vitit 2020:

- Për herë të parë në historinë e sektorit të energjisë të Republikës së Kosovës filloi alokimi i kapaciteteve interkonektive (ndërshtetërore) nën mbikëqyrje nga KOSTT dhe inkasimi i të hyrave nga shitja e tyre
- Përfundimisht pas më shumë se 4 vitesh nga përfundimi i ndërtimit u funksionalizua nga aspekti komercial linja interkonektive e tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri. Investim i përbashkët me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW.
- U krijuan kushtet për zhvillimin e proceseve të nevojshme drejt funksionalizimit të Bursës Shqiptare të Energjisë-ALPEX - Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri.

Marrëveshja e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E e votuar ka afat dy vjeçar.

## KOSTT kompani lidere në sektorin publik për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës – KOSTT u çertifikua me Standardin ndërkombëtar ISO 27001:2013, gjegjësisht Standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit (ISMS). Përmes këtij çertifikimi globalisht të njohur, KOSTT tregon angazhim serioz në zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në sigurinë e informacionit, mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit konform standardit ISO/IEC 27001:2013. Me rastin e pranimit të çertifikatës Jusuf Imeri, menaxher i Politikave dhe Cilësisë në KOSTT theksoi “Ne tashmë kemi ndërtuar një sistem të integruar të cilësisë në bazë të së cilës janë të mbështetura proceset. Kjo përbën një vlerë të shtuar



për kompaninë duke siguruar kështu ofrimin e shërbimit cilësor në përputhje me standarde të përcaktuara ndërkombëtare të cilat na ndihmojnë në zbatimin efikas të kërkesave ligjore, rregullatore dhe palëve të interesit.” Standardi për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001:2013 është standardi i katërt ndërkombëtar me të cilin tashmë u çertifikua KOSTT krahas Standardit për menaxhimin e Cilësisë ISO 9001:2015, Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë ISO 45001:2018, dhe Standardin e Mbrojtjes së Mjedisit ISO 14001:2015. Me këtë KOSTT bëhet kompania e parë publike dhe kompania e parë në sektorin e energjisë në Kosovë e çertifikuar me standardin ndërkombëtar ISO/IEC 27001:2013, duke e përmbyllur kështu vitin 2021 me një sukses që dëshmon vazhdimësi të ekselencës së biznesit.

## ALPEX nënshkroi marrëveshjen për implementimin e platformës elektronike të tregtimit

Më 10 shkurt 2022 në praninë e Zv. Ministrit të Energjisë së Shqipërisë, Enteve Rregullatore të Kosovës dhe Shqipërisë, përfaqësuesve të US-AID dhe Aksionerëve të ALPEX sh.a., OST dhe KOSTT u hodh një gur themeli i rëndësishëm për integrimin e tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX nënshkroi marrëveshjen për implementimin e Platformës së Tregtimit dhe Shërbimeve për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda Ditës. Kjo platformë mundëson operimin e tregut të organizuar në Kosovë dhe Shqipëri dhe integrimin me tregjet rajonale dhe evropiane si synim i ardhshëm i ALPEX.



## Kompletohet struktura e Bordit të Drejtorëve të KOSTT me emërimin e Komisionit të Auditimit nga ana e aksionarit



**JETON MEHMETI**  
Kryesues i Bordit të Drejtorëve



**ARBEN DODAJ**  
Anëtar i Bordit të Drejtorëve



**NEBIH ZARIQI**  
Anëtar i Bordit të Drejtorëve



**AJRINA GASHI HAMDIU**  
Anëtare e Bordit të Drejtorëve



**LIZA MARKU**  
Anëtare e Bordit të Drejtorëve



**SEAD MUJOVI**  
Anëtar i Bordit të Drejtorëve



**SABRI MUSIQI ud.**  
Kryeshef Ekzekutiv  
Anëtar i Bordit të Drejtorëve

**Aktualisht Bordi i Drejtorëve të KOSTT përbëhet nga z.Jeton Mehmeti – Kryesues, z.Arben Dodaj, z.Nebih Zariqi, znj.Ajrina Gashi-Hamdiu, znj.Liza Marku, z.Sead Mujovi dhe z.Sabri Musiqi U.D. Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT. (Gusht 2022)**

Me 16 mars 2022 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar Komisionin e Auditimit të KOSTT në përbërje të Liza Marku-Kryesuese, Arben Dodaj dhe Sead Mujovi dhe me këtë u kompletua struktura primare e Bordit të Drejtorëve të KOSTT sipas legjislacionit korporativ dhe legjislacionit të sektorit të energjisë në fuqi. Në pajtim me parimet e qeverisjes korporative, Bordi i Drejtorëve demonstroi një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e zbatimit të objektivave strategjike të përcaktuara me Planin e Biznesit, dhe në zbatimin e praktikave të qeverisjes së përgjegjshme në interes të aksionarit. Gjithashtu, roli i

Komisionit të Auditimit si strukturë e përheshme e bordit është i rëndësishëm së veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies për proceset financiare dhe të proceseve të brendshme të kontrollit, si segmente të rëndësishme të qeverisjes korporative në ndërmarrjet publike. KOSTT SH.A. është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100 % të aksioneve shtetërore. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

# Nënshkruhen Marrëveshje për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell



**Gjatë vitit 2021 u nënshkruan dy Marrëveshje për Kyçje të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës.**

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Solar Energy Group Europe sh.p.k. z.Egbert Schnuse, nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me diell (SGJED), me kapacitet gjenerues prej 150MWp (136MWac). Stacioni Gjenerues Energjetik me Diell do të kyçet në rrjetin transmetues 110kV përmes linjës së re 110 kV me gjatësi rreth 6.5 km, e cila do të lidhet në NS 110/35kV Gjakova 1.

Pas shqyrtimit të aplikacionit nga KOSTT dhe nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçje në Sistemin Transmetues, Stacioni Gjenerues Energjetik me Diell do të ndërtohet në Komunën e Gjakovës nga Solar Energy Group Europe sh.p.k, dhe pritet që të fillojë me gjenerimin e megavateve të parë në vitin 2022.

Po ashtu, KOSTT nënshkroi edhe Marrëveshjen për Kyçje me drejtorët e kompanisë Dukagjini Solar sh.p.k z.Cristopher James dhe z.Fadil Hoxha për Stacionin Gjenerues Energjetik me Diell me kapacitet gjenerues prej 2x96MW. Ky Stacion do të kyçet në rrjetin transmetues 110kV përmes linjës së re e cila do të lidhet në NS 400/110 kV Peja 3. Bazuar në aplikacionin e kompanisë Dukagjini Solar dhe në pajtuesmëri me Kodin e Kyçjes dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes për Kyçje në Sistemin Transmetues, SGJED 20/110kV Terstenik me kapacitet prodhues 96MW dhe SGJED 20/110kV Sverke gjithashtu me kapacitet prodhues 96MW e cila do të ndërtohet në Komunën e Pejës nga Dukagjini Solar sh.p.k, pritet që të fillojë me gjenerimin e megavateve të parë në vitin 2023.

# Avancimi dhe zhvillimi i të rinjve mbetet ndër prioritetet e KOSTT



Në kuadër të përkushtimit për mbështetjen e rinisë, më 25 Shkurt 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe përfaqësuesi i Fondit për Edukim Kosovar Amerikan (KAEF) z. Gjani Shporta, nënshkruan marrëveshjen për mbështetje të programit të KAEF i cili i mundëson studentëve të diplomuar në universitetet e Kosovës shkollimin e nivelit Master në universitetet më prestigjioze në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Hasani theksoi "Zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia e përgjithshme e qytetarëve është e ndërlidhur ngusht me arsimimin kualitativ, andaj KOSTT mbetet e përkushtuar në fuqizimin e gjeneratave të reja të vendit përmes mundësimit të edukimit dhe zhvillimit të të rinjve në programe të specializuara prestigjioze. Investimi në edukim është investim në të ardhmen



ë ndritur të Kosovës." theksoi ai.

Që nga viti 2010, KOSTT ka qenë partner aktiv i KAEF dhe do të vazhdojë të jetë kontribues në zhvillim të qëndrueshëm përmes edukimit dhe zhvillimit të të rinjve në fusha të ndryshme të specializuara e me fokus në fushën e inxhinierisë.

## KOSTT promovon barazinë gjinore në vendin e punës

Në kuadër të Programit ndërkombëtar për lidhshmëri, i zhvilluar në partneritet me Agjencinë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID), në mars të vitit 2021 tre përfaqësues të KOSTT u diplomuan në Shkollën e Biznesit – McDonough, Universiteti Georgetown, në Programin e Lidhshmërit Ekzekutiv për Barazi Gjinore.

Programi në fjalë i USAID, aplikon kurrikulën më të mirë në këtë kategori, që fuqizon ndërmarrjet nga mbarë bota në integrimin efektiv të iniciativave të barazisë gjinore brenda strukturave të korporatave të tyre. Nga ky program gati dy-vjeçar pjesë e së cilit ishte edhe KOSTT, u diplomuan tridhjetë menaxherë që punojnë në ndërmarrjet e ujësjellsit

dhe energjisë nga vende të ndryshme të botës, me ç'rast procesi mësimor i vitit të fundit u mbajt në mënyrë virtuale për shkak të pandemisë nga COVID-19. "I jam mirënjohës USAID për mbështetjen e vazhdueshme drejtuar KOSTT-it derisa gjithnjë mbes i përkushtuar në fuqizimin e rolit të gruas dhe sigurimin e mundësive të barabarta pa dallim gjinie në kompaninë tonë. Këto, janë dy elemente të cilat i konsideroj si thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik", theksoi Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani. "Programi i Leadershipit Ekzekutiv të Barazisë Gjimore ndihmon kompaninë tonë që të përmbushë mandatin për barazi gjimore dhe të krijojë më shumë mundësi për gratë që të kenë sukses" u shprehën njëzëri ekipi KOSTT që ishte pjesë e programit. "Ne e dimë që përkushtimi ndaj barazisë gjimore mund të frymëzojë inovacionin si dhe të tërheqë dhe të ruajë talentin më të mirë. Ne gjithashtu e dimë që kur kemi më shumë gra në sektorë tradicionalisht të mbizotëruar nga meshkujt, organizata përfiton nga njohuri të reja dhe më të ndryshme për të trajtuar sfidat e biznesit. "Programi i leadershipit i mëson pjesëmarrësit për të analizuar politikat dhe praktikat ekzistuese të kompanisë të cilat trajtojnë pabarazitë gjimore, si dhe për të përmirësuar performancën e kompanisë. Së bashku me trajnerin e tyre të përkushtuar për menaxhim të ndryshimeve, pjesëmarrësit nga ndërmarrjet partnere krijojnë plane veprimi për të adresuar boshllëqet dhe për të monitoruar përparimin e tyre drejt krijimit të një vendi pune ku ka barazi. Duke përdorur një mjet të personalizuar të kartelës me pikë të arritshmërisë, pjesëmarrësit dhe trajnerët e tyre u ndihmojnë organizatave që të marrin vendime strategjike, të bazuara në të dhëna, për t'i dhënë përparësi ndërhyrjeve të barazisë gjimore dhe për të përcjellur progresin e këtyre ndërhyrjeve dhe ndikimin e tyre në performancën organizative. "Gratë janë të nënpërfaqësuar në fuqinë punëtore globale zyrtare, dhe veçanërisht në industrinë e mbizotëruara



nga burrat, si sektorët e energjisë dhe ujit. Kjo nuk është thjesht një çështje e drejtësisë, por është një mundësi e humbur ekonomike", tha Corinne Hart, Këshilltare e Lartë për Barazi Gjimore nga USAID. "Studimet e ndryshme tregojnë se kur gratë shërbejnë si udhëheqëse dhe punonjëse të ndërmarrjeve private, bizneset përfitojnë dhe performanca e tyre përmirësohet." Një studim i zhvilluar së fundmi nga McKinsey ka analizuar më shumë se 1.000 kompani të 12 shteteve të ndryshme dhe ka arritur në përfundim se kompanitë të cilat kishin diversitet gjinor kishin më shumë gjasa të tejkalojnë mesataren e tyre të industrisë kombëtare për sa i përket përfitimit. Kompanitë të cilat kishin borde me përbërje të ndryshme gjimore, gjatë periudhave të krizës ose paqëndrueshmërisë, i tejkalonin kompanitë të cilat në bordet e tyre nuk kishin të përfshira gra. Programi i leadershipit është pjesë e programit të USAID "Engendering Utilities", i cili program bashkëpunon me 29 ndërmarrje të ujësjellësit dhe energjisë në 21 shtete të ndryshme me qëllim të krijimit të mundësive ekonomike për gratë. Programi "Engendering Utilities" ka mbështetur partnerët e kompanive në zbatimin e gati 450 ndërhyrjeve për barazi gjimore në organizatat e tyre. Këto ndërhyrje kanë rezultuar në punësimin e 1,115 grave, ndërsa gati 1000 gra janë ngritur në detyrë në ndërmarrjet partnere. Në Programin e Leadershipit Ekzekutiv të Barazisë Gjimore, pjesëmarrës nga KOSTT ishin Alban Imeri, Arjeta Gashi dhe Arijeta Pajaziti-Qerimi.



# #KOSTT mundëson punë praktike për personat me Sindromën Down

Promovimi i gjithpërfshirjes sociale dhe i mundësive të barabarta si pjesë përbërëse të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm janë pjesë e përgjegjësisë korporative ku mobilizimi i komunitetit biznesor luan rol të rëndësishëm. Në këtë drejtim, integrimi i komunitetit me Sindromën Down dhe përgatitja e të rinjve të këtij komuniteti të ndjeshëm për një jetë të pavarur, po mundësohet nga ana e #KOSTT përmes punës praktike të ofruar për Medinën dhe Dionisin. Këta dy të rinj tashmë kanë filluar praktikën 3 mujore dhe janë shumë të entuziazmuar për mundësinë që i'u ka ofruar KOSTT ku ata kanë gjetur një ambient miqësor dhe interesant pune. Derisa Dionisi me të drejtë thekson që "E drejta për punësim është e drejtë e garantuar", Medina në anën tjetër potencon potencialin që ata si komunitet kanë për të krijuar "Mos shiko çfarë mundem, por sa shumë mundem" shprehet ajo. Në Ditën Botërore të Sindromës Down, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani theksoi "jam i lumtur për mundësinë të cilën i'u kemi ofruar dy të rinjve me Sindromën Down me qëllimin për t'i



përgatitur dhe motivuar për të ardhmen e tyre në tregun e punës. Shpresoj që kjo të shërbejë në sensibilizimin e mëtutjeshëm të komunitetit biznesor në sektorin e energjisë në këtë drejtim", u shpreh ai. Puna praktike për dy të rinjët u mundësua falë partneritetit që ka krijuar KOSTT me Shoqatën #DownSyndromeKosova përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në mes të dy institucioneve.

## Menaxhmenti i KOSTT realizoi takim me përfaqësuesit e Tetra Tech

Menaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin ekzekutiv z.Mustafë Hasani realizuan takim konsultativ me përfaqësuesit e kompanisë Tetra Tech, implementuese e projektit mbështetës të USAID për sektorin e energjisë "Aktiviteti i Qëndrueshmërisë së Energjisë në Kosovë". Në kuadër të takimit u diskutua rreth proceseve aktuale në KOSTT si dhe rreth prioriteteve në kuadër të objektivave të përcaktuara të projektit. Projekti për një periudhë pesë vjeçare, në mes tjerash, do të ofrojë përkrahje për KOSTT në avansimin e tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri përfshirë integrimin e mëtutjeshëm në tregun rajonal si dhe integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në Sistemin e Transmetimit përfshirë çështjen e bal-



ancimit të sistemit. Me këtë rast, z.Hasani shprehu falënderimin e tij për mbështetjen e vazhdueshme të USAID për KOSTT si dhe mirëpriti bashkëpunimin e mëtutjeshëm në drejtim të ngritjes së kapaciteteve në funksion të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në vend.

## KOSTT nënshkruan kontratë për ndërtim të nënstacionit të ri në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Komunën e Ferizajt

Me 31 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani nënshkroi kontratën me përfaqësuesen e kompanisë ABB Power Grids Zagreb, znj. Nina Dusper Sushiq për implementimin e projektit për ndërtim të Nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizajt 3. Ky investim kapital i KOSTT në vlerë prej mbi € 4.7 milion përveç ndërtimit të nënstacionit të ri në Komunën e Ferizajt parasheh edhe instalimin e transformatorit energjetik me fuqi prej 40 MVA (mega volt amper) në këtë nënstacion. Implementimi i projektit do të ketë ndikim të theksuar në rritjen e sigurisë dhe të kualitetit të furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit për rajonin e Komunës së Ferizajt duke mundësuar kushte për zhvillim të mëtejshëm ekonomik të komunës me rrethinë. Me rastin e nënshkrimit të kontratës, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani theksoi "Zhvillimi i vazhdueshëm i Sistemit të Transmetimit të Kosovës



është prioritet i KOSTT dhe ne jemi të përkushtuar që përmes planifikimit zhvillimor afatgjatë dhe investimeve adekuatë të ofrojmë shërbime cilësore për shfrytëzuesit e sistemit duke kontribuar kështu në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë si shtyllë kryesore e zhvillimit ekonomik dhe social në vend." Nga momenti i fillimit të punimeve, implementimi i projektit parashihet që të përfundojë në afat prej 24 muajsh

## Përfaqësues të KFOR-it britanez vizituan KOSTT

Në vazhdimësi të bashkëpunimit ndër-institucional, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë, pritën në takim përfaqësuesit e kontigjentit të Britanisë së Madhe në kuadër të KFOR z.Charlie Mackaness dhe Nick Moss. Përfaqësuesit e KFOR u informuan nga afër në lidhje me gjendjen aktuale si dhe funksionimin e gjithmbarshëm të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës me fokus në operimin e sistemit të transmetimit si hallkë kyçe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend.

Në kuadër të vizitës, ekipi i paqeruajtësve të KFOR gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dis-



peçerike në KOSTT prej nga operohet, monitorohet dhe komandohet Sistemi i Transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.

## Menaxhementi i KOSTT priti në takim drejtorin e çështjeve politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë priti në takim drejtorin e çështjeve politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës z.Sylë Ukshini. Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, z.Ukshini u njoftua për procesin e gjatë disavjeçar nëpër të cilin ka kaluar #KOSTT drejt pavarësishtit energjetik të Kosovës nga Blloku SMM dhe fillimit të operimit të pavarur në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E. “Nga data 14 dhjetor 2020 kur hyri në fuqi Marrëveshja e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, kemi një realitet të ri të funksionimit të pavarur të KOSTT në kuadër të Bllokut AK me Shqipërinë i cili po tregohet i suksesshëm dhe në këtë drejtim edhe performansa e KOSTT në balancimin e sistemit të Kosovës pas pavarësishtit, është vlerësuar lartë nga ana e Qendrës Koordinuese për Evropën Kontinentale-Swissgrid,



në kuadër të ENTSO-E)” theksoi z.Hasani. Me këtë rast, drejtori i çështjeve politike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, z.Ukshini përgëzoi KOSTT-in për sukseset dhe të arriturat në këtë drejtim. z.Ukshini gjithashtu vizitoi edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT ku u njoftua rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës

## Bashkëpunimi i KOSTT dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë vazhdon

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z.Qemajl Minxhozi realizoi disa takime me Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z.Mustafë Hasani gjatë vitit 2021 ku biseduan rreth bashkëpunimit të frytshëm në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në sektorin e energjisë si dhe operimin e suksesshëm të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë (Blloku AK). Duke marrë në konsiderim komplementaritetin e dy sistemeve energjetike, diversifikimin e burimeve të energjisë si dhe mbështetjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, në kuadër të takimeve Ambasadori Minxhozi dhe z.Hasani u pajtuan që avansimi i



mëtutjeshëm i bashkëpunimit është në interes të të dy vendeve.



## Ambasadori i RF Gjermane në Kosovë priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT

Ambasadori i Republikës Federale Gjermane Sh.T.Z. Jörn Rohde me 29 prill 2021 priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT sh.a, në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Mustafë Hasani. Me këtë rast, z. Hasani falënderoi Qeverinë Gjermane dhe KfW për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm që nga themelimi i KOSTT dhe në vazhdimësi. Z.Hasani gjithashtu e informoi Ambasadorin Rohde rreth zhvillimeve aktuale si dhe përgatitjeve në lidhje me investimet zhvillimore në pesë vitet e ardhshme të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të mëtutjeshëm të rrjetit të transmetimit të Republikës së Kosovës si hallkë kyçe në sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Ambasadori Rohde, duke theksuar se mbetet i kënaqur me rezultatet e arritura dhe progresin e KOSTT si në aspektin zhvillimor ashtu edhe të integritimit në mekanizmat ndërkombëtar, u shpreh "Gjermania si partner strategjik ka mbështetur dhe shoqëruar KOSTT-in që nga themelimi i tij në vitin 2006 dhe jam i gëzuar që edhe më tutje Gjermania do të



këshilloj dhe shoqëroj KOSTT-in përmes bankës së mirënjohur KfW." Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT në shenjë falenderimi ndaj RF të Gjermanisë ndau Mirënjohje për bashkëpunimin dhe kontributin si në aspektin zhvillimor ashtu dhe mbështetjen drejt operimit të pavarur të Sistemit të Transmetimit të Kosovës si zonë rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

# Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim Ministren e Ekonomisë znj. Artane Rizvanolli

Menaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin ekzekutiv z. Mustafë Hasani pritën në takim Ministren e Ekonomisë së Republikës së Kosovës znj. Artane Rizvanolli.



z. Hasani njoftoi ministren Rizvanolli me funksionimin dhe operimin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, si hallkë kyçe në zingjirin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike si dhe me rrugëtimin e KOSTT drejt pavarësisht energjetik të Kosovës nga Blloku SMM dhe fillimin e operimit të pavarur si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë. Ministria Rizvanolli u njoftua gjithashtu me angazhimet që po bëhen për menaxhimin, operimin dhe balancimin e suksesshëm dhe stabil të Sistemit të Transmetimit të Kosovës në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E, si prioritet i rëndësishëm i KOSTT edhe karshi obligimeve ndërkombëtare në kuadër të Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E. Ministria e Ekonomisë përgëzoi KOSTT-in për punën profesionale dhe vlerësoi lartë arritjet e KOSTT në të gjitha drejtimet. “Është meritë e veçantë e juaja, e gjithë punonjësve të KOSTT ky progres i arritur si në funksionimin e sistemit të transmetimit në



Kosovë ashtu edhe në integrimin dhe avansimin e Kosovës/KOSTT në mekanizmat ndërkombëtar të sektorit të energjisë”. Ministria Rizvanolli theksoi që sektori i energjisë është një nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe bashkëpunimi me KOSTT, si një nga akterët kyç në sigurinë e furnizimit është i rëndësishëm së veçantë. Ministria Rizvanolli gjithashtu vizitoi edhe Qendrën Nacionale Dispečerike në KOSTT ku u njoftua rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës.

## KOSTT vlerëson partneritetin e vazhdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit të vazhdueshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, pritën në takim Joseph Farbeann, zyrtar ekonomik politik në Ambasadën e SHBA në Kosovë dhe z.Arben Nagavci specialist i menaxhimit të programit për energji në Agjencionin Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë. Zyrtarët e institucioneve amerikane u njoftuan për së afërmi rreth funksionimit të përgjithshëm të Sistemit të Transmetimit të Kosovës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe fillimit të operimit të pavarur si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë. Në kuadër të takimit z.Hasani theksoi "përkrahja e SHBA për KOSTT në zhvillimin e mëtutjeshëm të tregut të energjisë dhe integrim si dhe në aspektet e tjera luan rol të rëndësishëm në përforcimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për qytetarët. Vlerësoj lartë partneritetin të cilin e kemi ndërtuar ndër vite me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbështetja e vazhdueshme në procese të rëndësishme për KOSTT, mbetet e rëndësishme së veçantë për përparimin e sektorit". Në kuadër të vlerësimit të bashkëpun-



imit dhe përkrahjes së përhershme, Kryeshefi i KOSTT z.Mustafë Hasani dorëzoi mirënjohje për Ambasadën e SHBA në Kosovë si dhe për USAID. z.Farbeann dhe z.Nagavci vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT ku u njoftuan rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit ndër-institucional menaxhmenti i KOSTT realizuan takim me zyrtarët e lartë të Ambasadës Amerikane në Kosovë edhe në muajin Shtator të vitit 2021 me z. Joseph Farbeann - zyrtar ekonomik politik dhe z.David D.R. Seckinger - udhëheqës i njësisë ekonomike, si dhe z.Arben Nagavci specialist i menaxhimit të programit për energji në Agjencionin Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë.

## KOSTT përfitues i grantit të USAID për avancimin e barazisë gjinore

Në kuadër programit të USAID/Workforce Advancement for Gender Equality (WAGE), KOSTT është përzgjedhur përfitues i grantit për implementimin e projektit "Barazia gjinore për energji më të mirë" që do të zbatohet nga KOSTT nga muaji Prill 2021 deri Dhjetor 2021. Që nga viti 2018, KOSTT ka bashkëpunuar me USAID për çështje gjinore edhe përmes

programit EngenderingUtilities, program ky i lansuar në vitin 2015 dhe i cili përfaqëson angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmes USAID, për të promovuar një rrugë drejtë qëndrueshmërisë në vendet në zhvillim duke nxitur inovacionin e ndërmarrjeve, rritjen ekonomike përfshirëse, barazinë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave.



## Mbahet mbledhja e përgjithshme vjetore me përfaqësuesin e aksionarit

Bordi i Drejtorëve të KOSTT udhëhequr nga Kryesuesi z.Jeton Mehmeti si dhe menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, me 11 qershor 2021 zhvilluan mbledhjen e përgjithshme vjetore me përfaqësuesin e aksionarit/Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Driton Tali, ku u prezantua dhe shqyrtua Raporti Vjetor për vitin 2020, Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2020 si dhe performansa e menaxhmentit gjatë vitit. Përfaqësuesi i aksionarit u njoftua nga afër se përkundër sfidave me të cilat u ballafaqua i gjithë globi si pasojë e pandemisë Covid-19, KOSTT mbeti i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe të besueshme për palët e kyçura në Sistemin e Transmetimit të Kosovës, derisa viti 2020 u përmbyll me rezultate të theksuara gjithëpërfshirëse dhe suksese të cilat shënuan arritje historike jo vetëm për kompaninë, por edhe për gjithë sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës. Në kuadër të takimit gjithashtu u konstatua se stabiliteti dhe menaxhimi adekuat financiar në KOSTT janë vërtetuar me Raportin e Auditorit të pavarur në pasqyrat

financiare për vitin 2020 i cili ishte pa asnjë kualifikim. Pas shqyrtimit dhe diskutimeve, z.Driton Tali, përfaqësues i Kuvendit të Kosovës-aksionarit të KOSTT, duke përfaqësuar të gjitha aksionet e lëshuara dhe evidentuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe votat përkatëse, pa vërejtje miratoi Raportin vjetor për vitin 2020 si dhe Raportin e Auditorit të pavarur në pasqyrat financiare për të njëjtin vit. Në kuadër të mbledhjes ishte konkludim i përgjithshëm që menaxhmenti i KOSTT ka dhënë kontribut të pazëvendësueshëm si dhe ka treguar një angazhim maksimal për arritjen e objektivave të përcaktuara me Planin e Biznesit duke u dëshmuar me përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara, derisa të gjithë indikatorët e performancës tekniko-financiare ishin pozitive. z.Tali, gjithashtu vizitoi edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT ku u njoftua nga afër rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, të drejtat e aksionarit për KOSTT sh.a si kompani publike ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.





# U MBAJT FORUMI VIRTUAL

## “Roli i gruas në sektorin e energjisë - përvoja e KOSTT”

**Forum**  
**“ROLI I GRUAS NË SEKTORIN E ENERGJISË – PËRVOJA E KOSTT”**

**25 Qershor 2021**  
**15:00**  
**Linku për livestream: KOSTTFacebookPage**

 <b>Mustafë Hasani</b> Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT	 <b>Artane Rizvanolli</b> Ministre e Ekonomisë	 <b>Mimoza Kusari-Lila</b> Deputete në Kuvendin e Kosovës	 <b>Sarah Olmstead</b> Drejtoare për Kosovë, MCC	 <b>Aurora Polo,</b> Drejtoare e Kabinetit, OST Shqipëri
 <b>Jasmine Boehm</b> Këshilltare e menaxhimit të ndryshimeve, Tetra Tech	 <b>Xhyldane Këçmari</b> Anëtare e Bordit të Drejtoreshë, KOSTT	 <b>Kadri Kadriu</b> Zv Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT	 <b>Bukurije Dauti</b> Menaxhere e Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit, KOSTT	 <b>Zana Bajrami-Rama</b> Menaxhere për Komunikim dhe Relacion me Publikun, KOSTT

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 15 vjetorit të themelimit të KOSTT, me datë 25 Qershor 2021 nën udhëheqjen e zyrës për Komunikim dhe relacione me Publikun për here të pare në Kosovë u mbajt Forumi virtual me temë “Roli i gruas në sektorin e energjisë – përvoja e KOSTT”.

Pjesë e panelit të diskutimit në këtë ngjarje ishin: znj. Artane Rizvanolli (Ministre e Ekonomisë), znj. Mimoza Kusari-Lila (Deputete në Parlamentin e Kosovës), znj. Sarah Olmstead (Drejtoare për Kosovë, MCC), znj. Aurora Polo (Drejtoare e Kabinetit, OST Shqipëri), znj. Jasmine Boehm (Këshilltare e menaxhimit të ndryshimeve, Tetra Tech via zoom platform), Znj. Xhyldane Këçmari (Anëtare e Bordit, KOSTT), z. Mustafë Hasani (Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT), z. Kadri Kadriu (zv. Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT), znj. Bukurije Dauti (Menaxhere e Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit, KOSTT), Forumi u moderua nga znj. Zana Bajrami-Rama (Menaxhere për Komunikim dhe Relacione me Publikun, KOSTT)

Në fjalën e tij hyrëse Kryshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Hasani, tha: “Është vërtet kënaqësi të jam këtu në mesin e juaj me panelistë/e me përvojë të jashtëzakonshme shumë vjeçare dhe unë besoj që angazhimi dhe rezultatet e juaja janë padyshim inspirim edhe për gratë e tjera. Mund të themi lirisht që gruaja është shtyllë e palëkundur e shoqërsisë sonë në përgjithësi, këtë dëshirojmë ta dëshmojmë edhe ne si kompani. 15 vjetori i themelimit po përputhet me vitin e parë të pavarësisht elektroenergjetik ku gjithsesi roli i gruas inxhinierë në KOSTT është i vlerësuar jashtëzakonisht lartë dhe aritjet tona duhet ti adresohen gruas dhe prandaj mund të themi lirisht që nuk ka vend për

ndarje gjinore”.

“Sigurisht që zhvillimet e shekullit të fundit kanë qenë të pashembullta për avancimin e kësaj kauze por megjithatë na duhen vendime dhe veprime të guximshme në të gjithë botën jo vetëm në Kosovë, për të sjellur gratë në qendër të hapësirave të vendimarrjes në numra sa më të mëdhenj por edhe në kapacitet të plotë. Nuk ka dyshim që duhet bërë por kjo duhet bërë menjëherë.”, theksoi Ministria e Ekonomisë znj.Rizvanolli. Ajo tutje theksoi “ Kjo dëshmohet tutje përmes profesioneve si si në sektorin e energjisë ku vitet e fundit kemi pa rritje të madhe të përfaqësimit dhe kontributit nga gratë në të gjithë botën dhe në Kosovë. Mirëpo megjithatë kemi filluar nga një nivel shumë i ulët që do të thotë që megjithëse kemi pasur gjithë këto përparime sektori i energjisë ende mbetet fushë e dominuar nga burrat. Globalisht në sektorin e energjisë gratë përbëjnë vetëm 22% të fuqisë punëtore kjo është një shifër e cila duhet të ndysohet jo vetëm në Kosovë por edhe në vendet tjera, ndërsa nëse flasim për pozitat udhëheqëse në sektor ky hendek në mes të grave dhe burrave veçsa shkon e rritet.

Në anën tjetër, znj.Mimoza Kusari-Lila theksoi “Nga përvoja ime në tri nivele të qeverisjes, nga niveli loëal në nivelin ekzekutiv dhe tash në atë legjislativ e kam kuptuar qartë që ndryshimet nuk do të vijnë natyrisht, se tendenca për të prit ndryshimet të vijnë pa sforcim të politikave do të jenë tepër të gjata dhe me siguri të vonshme për kohën kur ne do të n’a duhet të arrijmë tek barazia.” Me këtë rast znj.Kusari gjithashtu potencoi edhe rolin e rëndësishëm që ka luajtur legjislativi I vendit në përcaktimin e kuotave gjinore në Bordet e ndërmarrjeve si dhe rëndësinë e politikbërjes dhe vendimarrjes për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në ndërmarrje dhe në sektorin e energjisë në përgjithësi.

Znj. Olmstead foli rreth iniciativave të shumta që ka ndërmarrë MCC kështu që vajzat dhe grate të bëhen pjesë e sektorit të energjisë. Ndër të tjera, gjatë diskutimit ajo u shpreh: Mendoj se energjia dhe dekarbonizimi janë në mendjen e të gjithëve dhe mendoj se njohuria është mundësia për të gjithë të rinjtë që mendojnë për karrierë në të ardhmën, të fillojnë të mendojnë për këtë sektor sepse ka shumë mundësi jo vetëm në Kosovë, por në Evropë dhe në mbarë botën”.

Ndërkaq sa l përket pjesëmarrjes së gruas në sektorin e energjisë në Republikës e Shqipërisë, znj.Aurora Polo nga OST Shqipëri theksoi “përfaqësimi l gruas në vitet e fundit në sektorin e energjisë nëShqipëri ka qenë një nxitës kryesor l zhvillimit ekonomik në vendin tonë. Sot prezantohet si një forcë orientuese ndaj ndryshimeve rrënjesore që po ndodhin në Shqipëri, progresi i shoqërisë në tërësi i sektorit të energjisë nëveçanti nuk mund të kishte tregues të lartë pa përfaqësimin e gruas si potencial i vlerave intelektuale, profesionale dhe drejtuese. Si vend me aspirata të larta për Bashkimin Evropian, Shqipëria është një ndër shtetet me përfaqësim të lartë të grave në postet drejtuese e sidomos në këto vitet e fundit.

Duke përgëzuar KOSTT për trajtimin e temës së barazisë gjinore pikërisht në përvjetorin e 15-të të kompanisë, Znj.Jasmine Boehm theksoi që kjo tregon për përkushtimin e lidershit të KOSTT për këtë çështje. Ajo gjithashtu komplementoi KOSTT për realizimin e video projektit duke theksuar “Është kënaqësi të shohësh të gjitha këto gra të zonja të KOSTT-it të bashkuara, dhe shpresoj që të shërbejnë si frymëzim për vajzat e rejat në të ardhmen” Ndër të tjera Znj. Bohem foli edhe për programin e USAID Engendering Utilities nga i cili ka përfituar KOSTT si dhe shprehu mirënjohje për hapat që janë ndërmarrë në KOSTT me aprovimin e politikave në fushën e barazisë gjinore.

Në anën tjetër, znj. Kicmari u shpreh: Në Kosovë tradicionalisht sektori i energjisë ka qenë i punësuar nga gjinia mashkullore, ka pas një numër të vogël të grave të cilat kanë mbajtur pozicione administrative. Fatmirësisht kohëve të fundit është promovu roli i grave në sektorin e energjisë dhe konsideroj që kjo nuk është e tëra që duhet bërë, por duhet bërë edhe më tepër që të përkrahen grate dhe vajzat e reja për ballafaqimet që i kanë për tu avancuar në fushat e energjisë dhe në fushat e tjera ku ato dëshirojnë të mbërrijnë ambicien e tyre. Konsideroj që modeli që po sjell KOSTT duhet të ndiqet edhe nga kompanitë tjera që janë në fushën energjisë siç janë KEK, KEDS, KESCO, BRE-të dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë , që ti jepin përkrahje ngritjes dhe përkrahjes profesionale të grave në energji dhe në fusha tjera.

Është me rendësi që jemi në një proces ku sektori energjetik po transformohet. Janë tri procese që po ndodhin, ajo që quhet dekarbonizim pra energjia

e gjelbert po fillon të dominoj në të ardhmën, ajo që pastaj lidhet me digjitalizim dhe e treta është decentralizimi. Në qoftese lidhim këto tri komponenta atëherë sektori I energjisë po bëhet më i komplikuar por po behet edhe shume më i mençur (smart). Ekperiencia ime ka treguar që femrat janë jashtëzakonishtë të përkushtuara në detaje dhe shpesh në sektorin e energjisë kanë rendësi detajet. Element tjetër i rendësishëm është që ky transformim është një shansë e madhe për të gjithë të rinjtë dhe ky transformim që po kalohet prej nje sistemi tradicional ku ndoshta një pjesë e madhe fizike po kalohet në punë mendore besoj që nuk ka dallime prandaj që tani është koha për njerëz të rinj, të mençur dhe këtu gjinia nuk luan rol”, u shpreh zv. Kryeshef Ekzekutiv z. Kadri Kadriu Duke folur për përvojën e saj shumëvjeçare në sektorin e energjisë dhe involvimin në shumë projekte kapitale të rëndësishme për zhvillimin e Sistemit të Transmetimit, znj. Bukurije Dauti ndër të tjera potencoi “inxhinieria dhe energjetika janë profesione shumë të mira dhe tani me zhvillimin dhe digjitalizimin e paisjeve dhe sistemit, atëherë është edhe më e lehtë puna dhe prosperiteti në atë drejtim. Nuk duhet pas frikë në asnjë moment që inxhinieria është e rëndë. Me një angazhim, me një dashuri ndaj profesionit,

me një vetbesim dhe përkushtim shumë të madh dhe përkrahje reciproke atëherë mund të arrihen të gjitha rezultatet. Është mirë ti përkrahim, dhe duhet së pari ne femrat me I perkrah femrat se vetëm atëher mund të arrihen rezultate edhe më të mëdha, u shpreh ajo. znj. Zana Bajrami Rama- Menaxhere për Komunikim dhe Relacione me Publikun në cilësinë e moderueses së Forumit theksoi që vet prezenca e personaliteteve dhe profesionistëve të këtij niveli tregon për rendësinë e kësaj kauze për arritjen e politikave për fuqizim të mëtutjeshëm të gruas, përfaqësimit të tyre në vendimmarrje si dhe inkurajimin për inkudrimin më të madh të vajzave në sektorin e energjisë përmes projekteve të ndryshme me ndikim.

Përfundimisht pjesëmarrësit duke falenderuar KOSTT për këtë organizim, u pajtuan që forumet dhe ngjarjet e tilla duhet të organizohen edhe në të ardhmen në funksion të promovimit dhe inkurajimit të vajzave për t’u kyçur në këtë profesion si dhe për të ndikuar në perfaqesimin sa më të mirë të grave në sektorin e energjisë dhe në përgjithësi në ekonominë e Kosovës. Gjatë këtij forumi u lansua edhe video-projekti “Inspirohu në energji” që promovon rolin dhe përvojën inspiruese të disa nga gratë e suksesshme punonjëse të KOSTT.



**Logo e përvjetorit është inspiruar nga arritjet historike të çmuara përgjatë viteve 2006-2021.**

Për shtetin e Kosovës,  
për qytetarët e vendit,  
për sektorin e energjisë,  
për integrimin e mëtutjeshëm ...



## Gonxhe Gashi- Haziri

**Menaxhere e Sektorit për Planifikim dhe Analizë Afatmesëm, KOSTT**

“Si bashkëthemeluese e Asociacionit të grave në sektorin e energjisë dhe si inxhinjere me përvojë rreth 22 vjeçare në sektorin e energjisë, mund të them se ka qenë një punë mjaft sfiduese e cila ka kërkuar një angazhim shumë të madh e posaqërisht për tu ndërlidhur me trendet e zhvillimit të sistemit elektroenergjetik të Evropes Qendrore dhe të Evropes Juglindore, pjesë e së cilës jemi edhe ne si KOSTT. Përgjatë këtij rrugëtimi, nuk ka munguar asnjëherë përkrahja dhe shkëmbimi i përvojave profesionale ndërkollegiale në mes të të dy gjinive”.



## Merita Zharku

**Përgjegjës i Njësisë për Procedurat e Prokurimit dhe Kontraktat, KOSTT**

“Për shkak të natyrës specifike të Sistemit elektro-energjetik, secili Aktivitet i Prokurimit në KOSTT ka sfidat e veta. Por me përkushtim, sinqeritet dhe profesionalizëm këto aktivitete finalizohen në projekte, shumica prej të cilave janë të rëndësishme strategjike.”



## Shukrije Fetahaj

**Menaxhere e Sektorit për Çështje Rregullative, KOSTT**

“Ashtu siç KOSTT është akter i rëndësishëm për sigurinë e furnizimit, poashtu puna dhe kontributi i të dy gjinive në KOSTT është shumë i rëndësishëm, e posaqërisht kontributi i gruas, përbën vlerë të pazëvendësuar. Barazia gjinore mund të arrihet vetëm duke bërë të mundur heqjen e hendekut gjinor që haset pothuajse në secilin sektor, por pak më shumë në sektorin e energjisë në përgjithësi. Prandaj duhet që vajzat e reja të kenë vullnet, guxim dhe vetëbesim dhe sa më shumë të orientohen duke studjuar shkencat teknike dhe të sfidohen duke u bërë lidere edhe në këtë sektor”...



## Prezantohet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e KOSTT për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 me infrastrukturë përcjellëse

Nën organizimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më 19 gusht 2021 në ambientet e Kuvendit Komunal të Ferizajt si dhe përmes platformës online Zoom është mbajtur Debat Publik për çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 me infrastrukturë përcjellëse. Në Debatin Publik në të cilin ishin të ftuar qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe të komunës së Ferizajt u prezantua Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) për këtë projekt, me ç'rast të gjitha palëve të interesuara u është ofruar mundësia që të parashirojnë pyetje për çështje me interes në lidhje me projektin. Raporti i VNM-së për këtë projekt i cili është prezentuar duke i konsideruar të gjitha ligjet dhe procedurat relevante sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ka pasur për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis si rezultat i këtij projekti si dhe identifikimin e masave të nevojshme



për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale. Në bazë të analizës së prezantuar përmes Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin kapital të KOSTT për ndërtimin e nënstationit të ri 110 kV Ferizaj 3, u konstatua që implementimi i këtij projekti nuk ka efekte të dëmshme domethënëse për mjedisin. Implementimi i projektit do të ketë ndikim pozitiv sa i përket krijimit të kushteve për furnizim cilësor me energji elektrike për qytetarët e Komunës së Ferizajt, nga aspekti i transmetimit si dhe do të ndikoj në hapjen e një perspektive të re për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në këtë komunë.

## KOSTT mirëpret miratimin e Udhërrëfyesit për implementimin e Marrëveshjeve të Energjisë në mes të Kosovës dhe Serbisë

KOSTT mirëpret miratimin e Udhërrëfyesit për implementimin e Marrëveshjeve të Energjisë në mes të Kosovës dhe Serbisë më 21 Qershor 2022 në Bruksel, në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Ky është një moment shumë i rëndësishëm në drejtim të normalizimit të situatës për pagesën e energjisë elektrike të konsu-

muar në pjesën veriore të Kosovës si dhe krijimit të kushteve për investime në asetet e vjetruara energjetike në pjesën veriore të Sistemit të Transmetimit të Kosovës, duke mundësuar kështu kushte për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për atë pjesë të vendit



## KOSTT shenon 15 vjetorin e themelimit dhe gjashtë muaj nga pavarësimi i sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës

Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës – KOSTT me datë 1 korrik 2021 shënoi 15 vjetorin e themelimit, me një ceremoni zyrtare e cila u organizua në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës në Prishtinë.

Në kuadër të kësaj ceremonie, gjithashtu u shenuan gjashtë muaj nga pavarësimi i Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe fillimi i operimit si zonë e pavarur në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E, si një arritur historike për sektorin e energjisë të Republikës së Kosovës. Duke marrë në konsideratë rëndësinë shtetërore e kombëtare të arritjeve të lartcekura, prezent në këtë ceremoni ishin SH.T.Z Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës, SH.T.Z Tomas Szunyog, Përfaqë-

sues Special i BE në Kosovësi dhe personalitete të tjera të larta shtetërore, të ambasadave të shteteve partnere në Kosovë, përfaqësues nga RGCE/ENTSO-E, përfaqësues të OST-ve rajonale si dhe akterë të tjerë vendor dhe ndërkombëtar nga sektori i energjisë.

Para të pranishmëve, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani foli mbi të arriturat kryesore përgjatë këtyre 15 viteve duke kulmuar me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E I cili ishte çelësi i progresit shumë-di-



menzional. Ai foli edhe për zhvillimin e Sistemit të Transmetimit, ku ndër të tjera theksoi “kapacitetet bartëse janë rritur për 101 % derisa në vitin që lame pas, përfundimisht u arrit që të plotësohet edhe kriteri teknik i sigurisë së furnizimit N-1 në sistemin e transmetimit duke siguruar kështu shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë së transmetimit të energjisë elektrike. Ne jemi krenar me të arriturat e KOSTT deri më tani, me zhvillimin dhe me stafin profesional të cilët janë të vendosur për të punuar për të ardhmen prosperuese të KOSTT dhe të sektorit të energjisë. Gjithsesi i jemi pafundësisht falënderues edhe partnerëve tanë strategjik të cilët na kanë mbështetur në vazhdimësi.”, theksoi z.Hasani.

Gjatë kësaj ceremonie, personalitete të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare shprehën lëvdata të shumta mbi punën dhe arritjet e KOSTT ndër vite.

“Ky 15-vjetor na ofron mundësinë që të festojmë progresin e KOSTT-it të arritur deri më tani, e më pas edhe të vlerësojmë sfidat, planet e prioritetet për të ardhmen e këtij institucioni të rëndësishëm të sektorit të energjisë në Kosovë. Përtej përpjekjeve për të ngritur sistemin e transmisionit brenda kufijve të Republikës së Kosovës, ne e vlerësojmë edhe punën që KOSTT bëri për të mbrojtur kufijtë e saj energjetik. Probleme të vazhdueshme me homologët tanë fqinjë e kanë ndjekur KOSTT-in deri tek arritja, në mendimin tim, më e madhe e këtij institucioni: Marrëveshja e Kyçjes në rrjetin e operatorëve European të transmisionit dhe sistemeve të energjisë, ENTSO-E. Pas shumë përpjekjeve, marrëveshja me ENTSO-E konfirmoi përfundimisht mëvetësinë e kufijve energjetik të Kosovës dhe, po aq rëndësishëm, hapi rrugën për bashkimin e tregjeve të energjisë me Shqipërinë dhe funksionimin e përbashkët brenda një zone rregullative”, u shpreh Kryeministri Kurti.

“Dëshiroj që në emër të Bashkimit Evropian të uroj KOSTT-in për 15 vjetorin e themelimit dhe të përgëzoj zotimin dhe përpjekjet për ofrim të shërbimeve të sigurta dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Përgjatë viteve dhe veçanërisht që nga hyrja në fuqi e Mar-

rëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E, KOSTT-i është bërë një partner i besueshëm, kompetent dhe profesional dhe duhet të jeni krenarë për këtë. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me ENTSO-E, përfshirë për çështjet e pazgjidhura që ndërlidhen me të kaluarën, do të vë edhe më shumë në pah angazhimin tuaj si partner i përgjegjshëm në Evropë. Rishikimi i vazhdueshëm i Strategjisë për Energjinë dhe Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030 është shumë i rëndësishëm për shtrimin e rrugës drejt dekarbonizimit të ekonomisë së Kosovës” - tha Z. Tomas Szunyog, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë.

Është nder të jem me ju dhe dëshiroj të shpreh gëzimin tim. Edhe komuniteti i energjisë feston 15 vjetorin dhe Kosova si palë kontraktuese ka qenë gjatë gjithë kohës me ne dhe duke filluar praktikisht nga zero për t’u bërë anëtare e familjes evropiane - të paktën kur flasim për operatorin e sistemit të transmisionit të energjisë elektrike. Sigurisht që ky vit ka qenë i veçantë, kjo është edhe arsyeja pse po festojmë së bashku. Ky trend i ri është duke ndodhur në mbarë Evropën, këtu dua të theksoj se ky tranzicion energjetik nuk është diçka që KOSTT-i apo palët e interesit në energji mund ta menaxhojnë si të vetme, por do të jetë më i gjerë, me ndikimin social-ekonomik, dhe natyrisht është një agjendë madhore për çdo vend të sotëm, për të gjithë shoqërinë dhe të gjitha autoritetet - e njëjta gjë do të jetë edhe në Kosovë. Ne si Sekretariat me kënaqësi do ju ndihmojmë në tejkalimin e të gjitha sfidave të ardhshme - tha Z. Janez Kopaç, Drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Gjatë fjalimit të tij, Z. Albino Marques, Nënkryetar i ENTSO-E/RGCE, deklaroi: “Në emrin tim dhe në emër të Laurent Rosseel dhe Sonya Twohig, dua të falënderoj KOSTT për ftesën që të marrë pjesë në këtë ceremoni. Është nder dhe privilegj që sot të jem virtualisht me ju, sigurisht që do të ishte shumë më mirë nëse do mund të isha personalisht në Prishtinë, por kjo fatkeqësisht nuk është e mundur për shkak të situatës pandemike në të cilën po jetojmë. Ashtu siç e dinë të gjithë, KOSTT si OST i Kosovës operon si një zonë auto-



nome rregulluese, që është integruar me OST e Shqipërisë në kuadër të bllokut të ri rregullues që nga 15 dhjetori i vitit 2020. Kjo ishte një arritje shumë e rëndësishme për KOSTT-in, për Kosovën dhe gjithë komunitetin e OST-ve që së bashku operojnë me sistemin e ndërlidhur të energjisë elektrike të Evropës Kontinentale nga Portugalia në Turqi. Që nga ajo datë e deri më sot, deficieti i përhershëm energjetik i sistemit të energjisë elektrike të Evropës Kontinentale që origjinon nga rajoni juaj - ndalon. Dua të përgëzoj menaxhmentin e lartë të KOSTT si dhe ekipet teknike për punën e bërë në vitet e fundit për arritjen e standardeve teknike të ENTSO-E.”

Administratori i OST Shqipëri z. Skerdi Drenova gjatë fjalimit të tij u shpreh: ‘Ky përvjetor do të mbahet mbend gjatë mbase siç u theksua mbartë me vete ngjarje historike për Sistemin Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës dhe veçanërisht për KOSTT, i cili vjen në këtë 15 vjetor i pamvarur nga Serbia duke operuar brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë. Ajo qka do të doja të përcjell me fjalimin tim sot është, dëshira dhe vullneti që kemi për të çuar përpara bashkëpunimin OST

dhe KOSTT. Sfidat janë të mëdha por kënaqësia që të ndeshemi me to është edhe më e madhe. E ardhmja fillon me fjalën e thjeshtë “treg” dhe kjo është nisë me tregun e balancimit dhe themelimin e Bursës shqiptare të energjisë elektrike, që është një nga reformat që ne kemi ndërmarr në sektorin e energjisë elektrike dhe është hapi me i rëndësishëm drejt një rritje dhe arritje tjera drejt zhvillimit të tregut të përbashkët të energjisë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, një treg plotësisht konkurrues dhe integruar.”

Në kuadër të ceremonisë solemne u ndanë mirënjohje për personalitet të cilët kanë pasur ndikim në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë e veçanërisht të KOSTT që nga themelimi i saj z. Ali Hamiti dhe z. Fadil Ismaili. Ndërkaq në mirënjohje të bashkëpunimit dhe përkrahjes së KOSTT në arritjen e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E pllakë falënderuese l’u nda z. z. Laurent Rosseel, ENTSO-E. s.

Me rastin e shenimit të 15 vjetorit të KOSTT u lansua edhe filmi dokumentar “Rrugëtimi i KOSTT drejt ENTSO-E”.

## Vëhet nën tension linja e re e tensionit të lartë 110 kV që lidhë NS 220/110 kV Kosova A me NS 110/35/10 kV Lipjani

Me datë 16 shtator 2021 KOSTT ka lëshuar nën tension linjen e re të tensionit të lartë 110 kV që lidhë Nënstacionet 220/110 kV Kosova A me NS 110/35/10 kV Lipjani. Linja në fjalë me gjatësi prej 3 km kalon në vendbanimet: Uglar



(përgjat Autostradës dhe Fushë Kosovë. Ndërtimi i linjës së re 100 kV NS Kosova A - NS Lipjani është projekt i KOSTT i bashkëfinancuar me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim #BERZH

## KOSTT fillon përgatitjet për investim kapital në ndërtimin e Nënstacionit të ri 110 kV në Ferizaj



Në vazhdimësi të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, KOSTT ka filluar përgatitjet për realizimin e investimit kapital për ndërtimin e nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV Ferizaj 3 (Kastriot). Në këtë drejtim, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani ka nënshkruar kontratë me Kryetarin e Komunës së Ferizajt z. Agim Aliu, për shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale për ndërtimin e nënstacionit të ri si dhe trasenë e linjës përcjellëse 110 kV. Me këtë rast z.Hasani theksoi “Ky investim i planifikuar i KOSTT në vlerë prej afër 6.5

milion EUR vjen si rezultat i rritjes së kërkesës për energji elektrike në Komunën e Ferizajt kryesisht për shkak të zhvillimit të shtuar të veprimtarive biznesore në këtë komunë. Andaj, me këtë investim, ne do të rrisim sigurinë e furnizimit nga aspekti i transmetimit, duke mundësuar kështu kushte për zhvillim të mëtejshëm ekonomik në këtë komunë”. Projekti për ndërtimin e Nënstacionit 110/35/10(20) kV Ferizaj 3 sipas teknologjisë më të fundit GIS, është projekt i KOSTT i planifikuar për realizim bazuar në Planin Zhvillimor të Transmetimit 2018-2027.

## KOSTT 1 vit zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri- Kosovë

Më 14 Dhjetor 2021 u shënuan 1 vit nga pavarësimi i Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe fillimi i operimit të KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E. Një kapitull i ri në funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës si dhe në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në vend. E arritur historike për sektorin e energjisë të Republikës së Kosovës.



# KOSTT vlerëson partneritetin e vazhdueshëm me Bankën Gjermane për Zhvillim-KfW



Në kuadër të bashkëpunimit dhe partneritetit të vazhdueshëm me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), u.d.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu me bashkëpunëtorë, pritën në takim delegacionin e KfW në krye me z.Pablo Obrador, udhëheqës i Divizionit të Energjisë dhe Transportit në Evropën Juglindore dhe Turqi, z. René Eschemann, drejtor i zyrës së KfW për Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut si dhe zyrtarë të tjerë të lartë të këtij institucioni. Në këtë takim z.Kadriu njoftoi të pranishmit rreth gjendjes aktuale dhe funksionimit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës në kuadër të Bllokut Rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë (Blloku AK). Delegacionet e KOSTT dhe KfW gjithashtu diskutuan edhe për zhvillimin dhe avansimin e mëtutjeshëm të Sistemit të Transmetimit të Kosovës në shërbim të rritjes së sigurisë së furnizimit, plotësimit të kriterëve teknike për anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E si dhe integrimin të burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE) në rrjet, si një proces i rëndësishëm në kuadër të diversifikimit të burimeve të energjisë dhe në funksion të tranzicionit energjetik vendor dhe global. Nga ana e tij, z.Obrador komplementoi KOSTT-in për menaxhimin e suksesshëm teknik të procesit të

pavarësimin dhe fillimit të operimit të pavarur në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E si dhe shprehu kënaqësinë për jetësimin e projektit të bashkëfinancuar me Qeverinë Gjermane përmes KfW të linjës interkonektive 400 kV Shqipëri-Kosovë. "KOSTT ndër vite ka dëshmuar se është partner i besueshëm i KfW dhe ne kemi interesim për të vazhduar bashkëpunimin e mëtutjeshëm", theksoi z.Obrador. Në kuadër të vlerësimit të partneritetit shumëvjeçar në mes të KOSTT dhe KfW, bashkëpunimit dhe mbështetjes së përhershme, u.d.Kryeshefi i KOSTT z.Kadri Kadriu dorëzoi mirënjohje për Bankën Gjermane për Zhvillim KfW. Me këtë rast z.Kadriu u shpreh "Jemi jashtëzakonisht mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme të Qeverisë Gjermane përmes KfW në procese të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar KOSTT. Besoj në vazhdimësinë e partneritetit tonë si një model i bashkëpunimit të suksesshëm gjermano-kosovar. Ne jemi të përkushtuar për të zhvilluar dhe modernizuar në vazhdimësi Sistemin e Transmetimit të energjisë elektrike si hallkë kyçe në zingjirin e sigurisë së furnizimit në vend dhe të ndërlidhur fuqishëm në rrjetin rajonal dhe atë evropian të energjisë elektrike" theksoi z.Kadriu.

# Nënshkruhet Marrëveshja mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë

Zyra e Rregullatorit të Energjisë #ZrRE dhe Enti Rregullator i Energjisë #ERE bashkërisht me operatorët e sistemit të transmetimit të të dyja vendeve #KOSTT dhe #OST me 21 Tetor 2021 në Tiranë nënshkruan marrëveshjen mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike. Përmes marrëveshjes palët nënshkruese e njohin Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike #ALPEX si bursën e vetme të energjisë elektrike për tregtim një ditë para (day ahead) dhe gjatë ditës (intra-day) për zonat tregtare të të dyja vendeve. Kjo marrëveshje njëherit është parakusht i marrëveshjeve pasuese që mundësojnë operacionalizimin e bursës së përbashkët të energjisë elektrike #ALPEX. Me këtë rast, u.d.Kryeshefi Ekzekutiv i #KOSTT z.Kadri Kadriu foli për rëndësinë e operacionalizimit të #ALPEX si dhe përkushtimin e KOSTT si një nga aksionarët që kjo të ndodhë sa më shpejt. "ALPEX do t'i ndihmoj të gjitha palëve të sektorit ?? tregtimin e energjisë elektrike në treg të lirë në baza afatshkurta, bazuar në parimet e jodiskriminimit, transparencës dhe kostos efek-



tive. Z.Kadriu njëherit ka falënderuar të gjithë mbështetësit financiar të projektit #USEA, #USAID etj për përkrahjen në këtë proces të rëndësishëm për sektorin e energjisë. Nënshkrimi i marrëveshjes u realizua në kuadër të takimit të grupit punues ligjor për definimin e aktiviteteve dhe marrëveshjeve që duhet të zbatohen në mënyrë që bursa e përbashkët e energjisë #ALPEX të bëhet funksionale gjatë vitit 2022.

## Menaxhmenti i KOSTT priti në takim delegacionin e Bankës Botërore

u.d Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu me bashkëpunëtorë priti në takim delegacionin e Bankës Botërore udhëhequr nga znj. Sudeshna Ghosh Banerjee, Menaxhere e Energjisë për Evropën dhe Azinë Qendrore. Në kuadër të takimit u diskutua rreth gjendjes aktuale të sektorit të energjisë në Kosovë me fokus në zhvillimet dhe gjendjen në sistemin e transmetimit. Tema të diskutimit gjithashtu ishin edhe planet zhvillimore për të ardhmen, rëndësia e integritetit të tregjeve të energjisë si dhe krijimi i kushteve për integritetin e burimeve të ripërtërishme të energjisë si një nga caqet e rëndësishme në rritjen e adekuacisë së gjenerimit në vend si dhe në rrugëtimin dre-



jt procesit të dekarbonizimit të sektorit të energjisë globalisht. u.d Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu shprehu mirënjohje për përkrahjen e Bankës Botërore në projekte të ndryshme për KOSTT si dhe të dy palët u dakorduan për vazhdimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit të frytshëm në mes të dy institucioneve.

# Delegacioni nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe KfW vizituan KOSTT



Bashkëpunimi në mes të RF të Gjermanisë dhe Kosovës në sektorin e energjisë me fokus në projektet për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit të transmetimit si faktorë të rëndësishëm në sigurinë e furnizimit dhe integritet në tregun rajonal dhe evropian të energjisë, ishin temat kyçe në takim-in e zhvilluar në mes të zyrtarëve të lartë të RF të Gjermanisë dhe Kosovës. Delegacioni i Qeverisë Gjermane në përbërje të Volker Oel, drejtor në Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik të RF të Gjermanisë (BMZ), Michaela Brinkhaus, zyrtare përgjegjëse për Kosovën nga BMZ, René Eschemann, drejtor i zyrës së KfW për Kosovë dhe Maqedoninë Veriore si dhe zyrtarë të tjerë të lartë nga KfW dhe GIZ u pritën në ambientet e KOSTT nga u.d.Kryeshf Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu, zv.Ministri për Ekonomi z.Mentor Arifaj, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë nga Ministria e Ekonomisë dhe KOSTT. Duke u falënderuar për kontributin e vazhdueshëm financiar të Qeverisë Gjermane përmes KfW në zhvillimin e Sistemit të Transmetimit të Kosovës ndër vite, u.d Kryeshf Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu i njoftoi të pranishmit rreth gjendjes aktuale dhe operimin në kuadër të Bllokut Rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë (Blloku AK) si dhe rëndësisë së bashkëpunimit dhe integritet në tregun rajonal dhe evropian të energjisë. Zv.Minis-

tri i Ekonomisë z.Mentor Arifaj foli rreth aktiviteteve dhe planeve të Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë si dhe shprehur kënaqësinë me bashkëpunimin në këtë sektor në mes të Kosovës/KOSTT dhe Shqipërisë. Sektori i energjisë është një nga prioritetet e bashkëpunimit për Republikën Federale të Gjermanisë dhe e falënderoj KOSTT-in për frymën e jashtëzakonshme të bashkëpunimit dhe arritjen e rezultateve për zhvillimin e sistemit të transmetimit me mbështetjen financiare të Qeverisë Gjermane nëpërmes KfW, theksoi z. Oel. Në kuadër të takimit gjithashtu u theksua rëndësia e bashkëpunimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit, në mbështetje të sigurisë së furnizimit me energji elektrike si faktor kyç për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e mirëqenie shoqërore në vend. z. Gazmend Kabashi-menaxher për zhvillim dhe planifikim afatgjatë në KOSTT, në kuadër të takimit prezantoi pasqyrën e Sistemit Elektro-energjetik të Kosovës, benefitet nga investimet e realizuara përfshirë krijimin e kushteve për integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit. Delegacionet gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispečerike në KOSTT ku u njoftuan rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit së Republikës së Kosovës.

## Deklarata e Sekretarit Amerikan të Shtetit për integrimin e tregut të energjisë Shqipëri-Kosovë

Në kuadër të punimeve të Këshillit të Energjisë SHBA-BE i cili u mbajt në Washington, Sekretari Amerikan i Shtetit Antony Blinken ndër të tjera ka vënë theks tek përparimi i integritit të tregut të energjisë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, duke theksuar "... Shqipëria dhe Kosova kanë krijuar një treg të për-

bashkët të energjisë elektrike, prodhimi i energjisë së rinovueshme është rritur dhe vendet në të gjithë rajonin tani po diversifikojnë burimet e energjisë." KOSTT falënderon të gjithë partnerët për mbështetjen e vazhdueshme në rrugëtimin për zhvillim dhe integrim të mëtutjeshëm

## Kriza energjetike globale reflektoi edhe në situatën energjetike në vend

Në fund të vitit 2021, Sistemi Elektro-Energjetik i Kosovës u përball me vëshirësi të theksuara si reflektim i rritjes së theksuar të konsumit të energjisë elektrike në vend, pamjaftueshmërisë së gjenerimit të brendshëm për të mbuluar konsumin dhe krizës globale energjetike që ka rezultuar me rritjen enorme të çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare.

Konsumi i energjisë elektrike në vend ka tejkaluar rekordet e rritjes normale me 10.8% rritje karahasuar me vitin e kaluar, derisa piku i ngarkesës në Sistemin e Transmetimit ka thyer rekordin e shënuar ndonjëherë me 1398 MW, ndërsa konsumi mesatar për orë është 1198 MWh/h. Ngarkesat e filla në sistemin energjetik shkaktajnë amortizim të konsiderueshëm të asetëve si dhe mbingarkesa në pajisjet elektrike.

Sipas indikacioneve, rritja e konsumit është si pasojë e përdorimit të energjisë elektrike në mënyrë masive për ngrohje nga ana e konsumatorëve.

Si rrjedhojë e mosbalancës së theksuar në mes të konsumit të energjisë elektrike në vend dhe energjisë së siguruar nga operatorët përgjegjës në treg, aktualisht janë duke u shkaktuar imbalance të mëdha ndaj sistemit interkonektiv, ku aktualisht rreth 40% e konsumit në Kosovë po tërhiqet nga sistemi interkonektiv i Evropës Kontinentale.

Qendra Koordinuese për Evropën Kontinentale në kuadër të ENTSO-E (SwissGrid) si dhe Grupi Regional i Evropës Kontinentale (RGCE) trup i ENT-

SO-E kanë kërkuar në mënyrë strikte ndërprën e menjëhershme të devijimeve ndaj rrjetit interkonektiv evropian. Derisa monitoruesi i Bllokut AK në vazhdimësi ka tërhequr vërejtjen zonës rregulluese të Kosovës për situatën.

Për të ruajtur integritetin e sistemit dhe kontribuar në balancimin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe atë Evropian, Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST-të) janë të obliguara që të ndërmarrin të gjitha veprimet për të balancuar konsumin, gjenerimin dhe importin brenda zonës së tyre rregulluese.

Me këtë rast, KOSTT bëri thirrje publike për të gjithë qytetarët, institucionet, në përgjithësi të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, që të shfrytëzojnë energjinë elektrike në mënyrë sa më racionale duke kursyer aty ku është e mundur. KOSTT gjithashtu kërkoi mobilizim të të gjitha palëve të licencuara në tregun e energjisë për të ndërmarrë masa në përputhje me përgjegjësitë e tyre për tejkallimin e situatës, që të shmangët zbatimin i masave të parapara me Kodin e Rrjetit/Kodi Operativ për zvogëlimin e konsumit si masë e fundit e veprimit.

Bashkërisht mund të ruajmë furnizimin stabil me energji elektrike dhe integritetin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës i cili tashmë 1 vit funksionon si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut AK e integruar në zonën sinkrone të Evropës Kontinentale, theksoi KOSTT në deklaratën publike.

## KOSTT pjesë e panelit në punëtorinë me Rrjetin e Bizneseve për Energji të Pastër-N4CEB

Nën organizimin e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare #OEGJK u mbajt punëtorinë me Rrjetin e Bizneseve për Energji të Pastër #N4CEB ku pjesë e panelit diskutues ishte u.d Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe përfaqësuesit të KEDS/KESCO. Në kuadër të prezantimit të z.Kadriu, i cili tërhoqi interesim të theksuar të audiencës, ai foli për rolin e rëndësishëm që ka luajtur KOSTT në krijimin e kushteve dhe mundësive për integrim dhe operim të burimeve të ripërtërishme të energjisë në rrjetin e transmetimit, duke ofruar kështu një kontribut thelbësor në rrugëtimin drejt procesit të dekarbonizimit. Në kuadër të punëtorisë, gjithashtu u trajtuan edhe aspektet teknike të fleksibilitetit dhe operimit në kohë reale të sistemit elektroenergjetik ndërlidhur me BRE-të si dhe zgjidhjet e planifikuara nga ek-



ipi i ekspertëve të KOSTT në këtë drejtim. Audiencia e punëtorisë në përbërje të përfaqësuesve të komunitetit të bizneseve, shoqërisë civile dhe ekspertëve të fushës së energjisë dhe të ekonomisë, theksoi rëndësinë e kuadrit ligjor që rregullon këtë fushë si dhe mundësitë që ofrohen nga zhvillimi dhe integrimi i mëtutjeshëm i tregut të energjisë.

## Punonjësit e mirëmbajtjes së linjave të KOSTT ngjiten në shtyllën e akullt elektrike në 30 m lartësi

Punonjësit e mirëmbajtjes së linjave të KOSTT ngjiten në shtyllën e akullt elektrike në 30 m lartësi, në kushte ekstreme atmosferike rreth -8 gradë celsius por me motivin për shërbim në interes publik. Që qytetarët të kenë furnizim të besueshëm me energji elektrike nga aspekti i transmetimit.

Guxim për t'u admiruar!

Pamjet nga punimet në izolator, linja 110 kV LP 179/2, NS Ferizaj 1-NS Theranda, shtylla nr.57.



## Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës shqyrtoi Raportin Vjetor të #KOSTT sh.a, për vitin 2021

Para komisionit raportin e prezantoi z. Jeton Mehmeti kryesues i Bordit të KOSTT, i cili në pika të shkurtra prezantoi punën, sfidat dhe vendimet e KOSTT gjatë vitit të kaluar si dhe U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu. Pas diskutimeve, komisioni miratoi Raportin Vjetor për vitin 2021

me asnjë votë kundër.

Para 1 viti, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti i Kuvendit të Republikës së Kosovës gjithashtu kishte miratuar raportin vjetor të KOSTT sh.a, për vitin 2020.

## Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit Ambasadës Franceze dhe të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD)

Menaxhmenti i KOSTT në krye me U.D Kryeshefin Ekzekutiv z. Kadri Kadriun, priten në takim delegacionin e Ambasadës së Francës në Kosovë e përfaqësuar nga znj. Cécilia Maronnier- Atashe për Bashkëpunim dhe përfaqësuesit e Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD) në krye me z. Olivier Grandvoinet, Udhëheqës i ekipit si dhe zyrtar të tjerë të këtij institucioni.

E pranishme në Ballkanin Perëndimor që nga viti 2019, për të mbështetur vendet në rajon drejt përmbushjes së standardeve të Bashkimit Evropian si dhe për të zbatuar Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimet klimatike, z. Grandvoinet prezantoi planet e AFD-së për shtrirjen edhe në Kosovë ku tashmë kanë vendosur kontaktet e para në sektorin e energjisë. Gjatë takimit, z.Kadriu njoftoi të pranishmit rreth gjendjes aktuale dhe funksionimit të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës në kuadër të Bllokut Rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë (Blloku AK) si dhe zgjerimin e kapaciteteve transmetuese në funksion të akomodimit të mëtutjeshëm të Buri-



meve të Ripërtërishme të Energjisë Elektrike dhe sfidat e operimit në funksion të integritetit në shkallë të gjerë të BRE drejtë procesit të dekarbonizimit të sektorit të energjisë. Me këtë rast z.Kadriu duke e falënderuar delegacionin për interesimin e tyre, u shpreh i gatshëm në ndërtimin e partneritetit në mes të dy institucioneve në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të vazhdueshëm të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.



## U mbajt Dëgjimi publik për projektin e ndërtimit të linjës së kombinuar 110 kV në Komunën e Ferizajit

Nën organizim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, u mbajt Dëgjimi Publik për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës së KOSTT për shpronësim dhe krijim të detyrueshëm të servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga implementimi i projektit: Ndërtimi i linjës së kombinuar të dyfishtë 110 kV për kyçjen e nënstacionit të ri NS Kastrioti 110/35/10(20) kV. Me datë 04 Maj 2022, në Kuvendin Komunal të Ferizajit u prezantua projekti për ndërtimin e linjës së kombinuar të dyfishtë 110 kV, e cila përbëhet nga 3 km linjë ajrore dhe rreth 500m kablo nëntokësore dhe kalon në zonat kadastrale të Komunës së Ferizajit: Prelez i Jerlive, Kosinë, Muhoc, Lloshkobare, Ferizaj dhe Talinoc i Jerlive. Gjatë kësaj seance dëgjimore ku morën pjesë qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve



qendrore dhe të Komunës së Ferizajit, përfaqësuesit e KOSTT sh.a, duke i falënderuar për interesimin, prezantuan projektin dhe rëndësinë që ka implementimi i këtij projekti për sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit si dhe ndikimin në hapjen e një perspektive të re për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në këtë komunë.

## U mbajt Mbledhja Komemorativë në nderim të personalitetit dhe veprës së ekspertit të shquar të sektorit të energjisë Skender Gjonbalaj

Nën organizimin e KOSTT sh.a, me 16 Maj 2022 u mbajt Mbledhja komemorativë në nderim të personalitetit dhe veprës së ekspertit të çmuar të sektorit të energjisë z. Skender Gjonbalaj, Drejtor i Operimit të Tregut në KOSTT, i cili u nda nga jeta pas një sëmundje të shkurtë e të rëndë. Skender Gjonbalaj dha kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin, operimin dhe në integrimin e tregut të energjisë të Kosovës. Bashkë-hartues i politikave rregullative të sektorit, dhe kontribues në politikat shtetërore të energjisë. Ai ishte gjithashtu një nga njerëzit kyç në krijimin e Bllokut energjetik Shqipëri-Kosovë, krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë dhe tregut të për-



bashkët Shqipëri-Kosovë. Skenderi ishte një ekspert shumë i çmuar, ishte profesionist i parimeve të larta, i përkushtuar e këmbëngulës në zhvillimin e avansimin e sektorit të energjisë. Në mbledhjen komemorativë sot në Prishtinë, përveç drejtuesve e bashkëkollegëve të KOSTT dhe familjes, pjesëmarrëse ishte edhe Ministria e Ekonomisë znj. Artane Rizvanolli si dhe drejtues e përfaqësues të shumtë të institucioneve të sektorit

të energjisë vendore dhe ndërkombëtare, miq e bashkëpunëtorë. Ne, me pikëllim të thellë i kemi dhënë lamtumirën e fundit Skenderit, por me veprat e tij ai do të mbetet gjithnjë pjesë e jona, pjesë e Sektorit të Energjisë në Kosovë!

# Reflektimi i kostove të sistemit elektroenergjetik është domosdoshmëri për mbrojtjen e integritetit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës

Kriza globale energjetike e cila u karakterizua me rritje të jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në bursat ndërkombëtare, pashmangshmërisht u reflektua edhe në Republikën e Kosovës sidomos në periudhën e stinës së dimrit kur konsumi i energjisë elektrike arriti në vlerat më të larta dhe ndikoi edhe në rritjen e importit të energjisë elektrike. Për të përmbushur përgjegjësitë për krijimin e kushteve për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe operimin e sigurt dhe të besueshëm të sistemit



të transmetimit përveç tjerash, KOSTT sikurse të gjitha kompanitë e tjera të rregulluara të sektorit të energjisë siguron operimin nga të hyrat e lejuara maksimale sipas aprovimit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Në situata kur të hyrat e realizuara nuk reflektojnë kostot reale, aplikohet procesi i përshtatjeve tarifore me qëllim të ruajtjes së likuiditetit të kompanisë dhe mundësimit të kushteve për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Si rrjedhojë e çmimeve enorme të importit të energjisë elektrike dhe të hyrave jo adekuate për mbulimin e kostove, deri më tani janë shkaktuar devijime të theksuara ndaj Sistemit Elektroenergjetik të Evropës Kontinentale të cilat kanë kosto, si dhe janë shkaktuar borxhe të ndërsjellta në mes të kompanive në sektorin e energjisë. Devijimet e mëdha ndaj sistemit interkonektiv nuk janë në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe paraqesin obligime financiare shtesë për KOSTT-in si zonë e pavarur rregulluese. Situata e krijuar nga kriza energjetike globalisht ka nxitur ndërmarrjen e masave proaktive përmes mekanizmave të formave të ndryshme

qoftë përmes përshtatjeve tarifore apo subvencionimeve të ndryshme të sektorit të energjisë në botë. KOSTT ngre zërin për pamundësinë e mbulimit të kostove të shkaktuara dhe atyre që pritet të ndodhin në qoftë se nuk ndërmerren masa të shpejta për të adresuar çështjen e kostove të sektorit qoftë përmes rritjes së tarifave apo subvencionimit. Nëse nuk ndodhin këto veprime atëherë do të rrezikohet siguria e furnizimit me energji elektrike në vend, do të aplikohet masa për reduktimin e konsumit si dhe rrezikohet seriozisht Marrëveshja e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E. Kërkesat që tarifa e energjisë të kthehet në vlerën e mëhershme e rrezikon sigurinë e operimit të sistemit, dëmton Marrëveshjen e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare si dhe arritjet e KOSTT në pavarësimin e operimit të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Rritja e çmimit të energjisë elektrike është pasojë e krizës globale të energjisë dhe ka prekur të gjitha vendet Evropiane, prandaj është i domosdoshëm reflektimi i kësaj kosto-je në të hyra shtesë.

## U mbajt Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin

Më 20 qershor 2022 në selinë qendrore të KOSTT Bordi i Drejtorëve në krye me Kryesuesin z.Jeton Mehmeti si dhe menaxhmenti i lartë në krye me U.D. Kryeshefin Ekzekutiv z.Kadri Kadriu, zhvilluan Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin, Kuvendin e Republikës së Kosovës të përfaqësuar nga z.Avni Zogjani. Si trupi më i lartë vendimarrës, në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin u shqyrtuan dhe unanimisht u aprovuan Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2021, Raporti Vjetor i KOSTT për vitin 2021, si dhe performanca e menaxhmentit në zbatimin e objektivave strategjike të kompanisë. Në kuadër të takimit, përfaqësuesi i aksionarit z. Avni Zogjani, u njoftua më hollësisht me performancën dhe të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2021 dhe njëkohësisht me sfidat përfshirë reflektimin e krizës energjetike globale me të cilën u karakterizua kjo periudhë. Në kuadër të takimit u potencua që përkundër situatës së jashtëzakonshme të krizës energjetike me të cilën u ballafaqua Kosova ashtu



sikurse edhe i gjithë globi në vitin 2021, KOSTT ka luajtur rol të rëndësishëm si në stabilitetin e rrjetit të brendshëm ashtu edhe në ruajtjen e integritetit të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës karshi atij Evropian. Përfaqësuesi i Aksionarit z.Avni Zogjani ka vlerësuar angazhimin dhe performancën e menaxhmentit në zbatimin e objektivave strategjike të kompanisë dhe njëherit ka shprehur përkrahjen e plotë për KOSTT. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nr.05/L-085 të miratuar në vitin 2016, të drejtat e aksionarit për KOSTT SH.A si kompani publike ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## Prezantohet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin e KOSTT për ndërtimin e Nënstacionit të ri GIS 110/35/10 (20) kV Fushë Kosovë

Nën organizimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më 15 korrik 2022 në ambientet e Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës si dhe përmes platformës online Zoom është mbajtur Debat Publik për çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri GIS 110/35/10 (20) kV në Fushë Kosovë. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) ka pasur për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis të këtij projekti si dhe identifikimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet eventuale. Në bazë të analizës së prezantuar përmes Raportit të VNM-së për projektin kapital të KOSTT për ndërtimin e nënstationit të ri GIS 110/35/10 (20) kV në Fushë Kosovë, u konstatua që implementimi i projektit dhe funksionimi i nënstationit nuk shkakton ndikime negative në mjedis dhe nuk rrezikon



shëndetin e njeriut. Për më tepër, implementimi i projektit do të ketë ndikim pozitiv sa i përket krijimit të kushteve për furnizim cilësor me energji elektrike për qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës, nga aspekti i transmetimit si dhe do të ndikoj në hapjen e një perspektive të re për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në këtë komunë. Në kuadër të Debatit Publik ku u prezantua Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) për këtë projekt, të gjitha palët e interesuara patën mundësinë që të parashitrojnë pyetje për çështje me interes në lidhje me projektin.

# KOSTT përshëndet nënshkrimin e Programit Kompakt në mes të Kosovës dhe SHBA , përfaqësuar nga MCC

KOSTT përshëndet nënshkrimin e Programit Kompakt në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës përfaqësuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit MCC në vlerë prej \$ 236.7 milion. Kjo marrëveshje është një gurthemel i rëndësishëm që do të kontribuojë në mënyrë thelbësore në procesin e tranzicionit të drejtë të energjisë për vendin tonë. Rritja e fleksibilitetit të sistemit dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për integrimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës, janë faktorë të rëndësishëm për sigurinë e furnizimit dhe rrugëtimin tonë drejt dekarbonizimit. Falemnderit SHBA për mbështetjen tuaj për



Photo Credits: Ministria e Ekonomisë

Kosovën për një të ardhme të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të sektorit të energjisë!

## #NeJemiKOSTT

**Përkushtimi dhe kontributi i secilit punonjës pa dallim është vlerë e çmuar në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike të kompanisë. Në kuadër të serisë së intervistave #NeJemiKOSTT këtë radhë ju prezantojmë.**

**Ganimete Sahiti-Ahmetaj**, ka përfunduar studimet dhe masterin në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Ekonomik drejtimi Banka, Financa dhe Kontabilitet. Rrugëtimin në Sektorin e Energjisë e filloi në shkurt të vitit 2011 në KOSTT dhe nga viti 2020 ajo mban pozitën Menaxhere e Sektorit të Kontabilitetit në kuadër të Departamentit të Financave. "Të qenurit pjesë e këtij sektori është shumë e rëndësishme për mua, duke pasur parasysh rëndësinë e energjisë në aspektin social dhe ekonomik. KOSTT është model e një ndërmarrjeje që ofron mundësi të avansimit profesional, përkrah talentët e rinj, si dhe e përkushtuar për zhvillim dhe trajnime të stafit. Fatmirësisht KOSTT i kushton rendësi veçantë mbështetjes dhe ngritjes profesionale të të dy gjinive pa dallim dhe mendoj që duhet të vazhdohet në këtë frymë, e sidomos me përkrahjen e gjinisë femërore, pasi që ato munden dhe duhet të jenë pjesë e vlefshme e sektorit të energjisë." u shpreh Ganimetja.



të

**Nazif Nazifi** përfundoi studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin e Prishtinës, drejtimi "Sisteme Elektroenergjetike". Rrugëtimi i tij në sektorin e energjisë ka filluar më herët, por angazhimi i tij në mënyrë profesionale ka filluar pas diplomimit kur edhe është punësuar në KOSTT

si inxhinier për testim, mirëmbajtje dhe akordim të releve dhe tani mban pozitën Senior Inxhinier në Sektorin e Mbrojtjeve Rele. “KOSTT si kompani gjithmonë i ka mbështetur dhe vazhdon ti mbështet kuadrot e veta, prandaj të punosh në KOSTT është së pari përgjegjësi e pastaj edhe privilegj. Ky është inspirim shtesë që të merresh me sektorin e energjisë. Roli dhe kontributi i dy gjinive pa dyshim se është i rëndësishëm në sektorin e energjisë dhe jo vetëm, prandaj ne si shoqëri duhet bërë përpjekje që paragjykimet eventuale ti largojmë, dhe t’u krijohet hapësirë e mundësi të gjithëve pa dallim. Mendoj se KOSTT në masë e ka plotësuar diversitetin gjinor, e kjo duhet ruajtur e plotësuar” u shpreh Nazifi.



**Minivere Idrizi** ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, Dega Kimi në Universitetin e Prishtinës në vitin 1991 si dhe mban titullin Master në Menaxhment dhe Informatikë që nga viti 2013 dhe mban pozitën Senior Specialiste për Mbrojtjen e Mjedisit. “Puna prej dy dekadash në sektorin e energjisë, njohja me proceset energjetike duke filluar nga minierat, gjenerimi dhe shpërndarja e energjisë dhe duke ditur efektet mjedisore të cilat ndikojnë në shëndetin e punonjësve dhe të komunitetit më bëjnë përgjegjëse për të vazhduar punën dhe angazhimin profesional në parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve mjedisore. Si profesioniste me përvojë 20 vjeçare në sektorin e energjisë në mbrojtjen e mjedisit inkurajoj gratë që të sfidohen të punojnë dhe të realizojnë ëndrrat e tyre edhe pse nuk është e lehtë në konkurrencë me meshkujt. Avancimi i gruas në këtë sektor bazuar në edukimin dhe përvojën duhet të përkrahët më shumë në ngritjen kadrovike dhe në vendimmarrje” u shpreh Miniverja.



**Sylejmon Raçi** përfundoi studimet për “Sistemet Elektroenergjetike” në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në vitin 2016 dhe që nga ajo kohë ai është i punësuar në KOSTT ku aktualisht mban pozitën e Inxhinierit specialist për operim të tregut. “Duke marrë parasysh rëndësinë aq të madhe të sektorit të energjisë në tërë aktivitetet ekonomike dhe shoqërore, dhe të jem pjesë e këtij sektori kaq të rëndësishëm atëherë ndjehesh i inspiruar për të vazhduar punën në këtë sektor. Shumëllojshmëria e këndvështrimeve mund të krijoj kreativitet, inovacion dhe të krijoj mundësi të reja për çdo organizatë. Po ashtu, përbërja e ekipeve nga dy gjinitë rrit bashkëpunimin në grup. Prandaj, kontributi i dy gjinive është shumë i rëndësishëm për kompani energjetike dhe për tërë sektorin e energjisë” u shpreh Sylejmoni.



**Valbona Canolli** është Inxhinierë e elektroteknikës e diplomuar në drejtimin “Sistemet Elektroenergjetike” në Fakultetin Elektroteknik në Universitetin e Prishtinës. Përvojen e saj më shumë se 14 vjeçare në sektorin e energjisë e filloi në Shkurt të vitit 2007, kur u punësu në KOSTT dhe tani mban pozitën Inxhinierë në Sektorin për Planifikim Operativ dhe Analizë afatshkurtë. “Duke i parë zhvillimet në sektorin e energjisë si dhe ndërlidhja e teknologjisë me këtë sektor në përgjithësi, kjo na ka obliguar dhe inspiruar që sa më tepër të jemi në trend me zhvillimet evropiane dhe botërore në këtë sektor, gjë që ka ndikuar edhe në zhvillimin e aftësive tona profesionale. Për të rritur diversitetin gjinor në sektorin e energjisë mendoj që femrat nuk duhet të hezitojnë të studiojnë në sektorin e energjisë dhe përmes ngritjes profesionale ato do ta dëshmojnë se janë të afta të punojnë dhe menaxhojnë në projekte të ndryshme në Sistemin Elektroenergjetik dhe në përgjithësi në sektorin e energjisë” u shpreh Valbona.



**Labinot Gashi** përfundoi studimet në vitin 2005 në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Departamenti i Elektroenergjetikës Industriale në Universitetin e Prishtinës, si dhe nga viti 2014 mban titullin Master në Shkencat e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike. Labinoti karrierën profesionale e filloi në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave në pozitën shef Sektori për Zbatimin e Reformave në Sektorin e Energjisë dhe që nga viti 2007 punon në KOSTT ku aktualisht mban titullin Senior Specialist për Çështje Rregullative. “Sektori i energjisë prezantohet si një forcë orientuese ndaj ndryshimeve rrënjësore që ndodhin në zhvillimin dhe orientimin e jetës. Mund të themi që është sektori i vetëm që krijon sfida atraktive ku zgjidhja e së cilave kërkon një përkushtim dhe njohuri orientuese të veçant. Duke pasur parasysh që edhe në jetën personale jam i inkurajuar për të rrugëtuar drejt zhvillimeve që në të kaluarën kanë përcaktuar, por edhe në të ardhmën përcaktojnë zhvillimin kryesor të një shoqërie, sektori i energjisë është vendi ku mund ti arrihet praktikisht njohuritë e tua teorike. Prandaj inspirohem të punoj në këtë sektor. Mund të them se pavarësisht aspektit gjinor aspiratat tua mund të arrihen në KOSTT nëse ti si synim kryesor e ke zhvillimin profesional dhe atë të karrierës përmes tejkalimit të sfidave profesionale” u shpreh Labinoti.



**Shpresa Baliu- Krasniqi** është Inxhiere e diplomuar në Fakultetin Elektroteknik në Universitetin e Prishtinës në drejtimin “Sistemet Elektroenergjetike”. Krugëtimin në sektorin e energjisë e filloi në vitin 2000 ku u angazhua në projekte të shumta vendore dhe ndërkombëtare. Nga viti 2006 vazhdoi punën në Departamentin e Zhvillimit të Rrjetit dhe Projekteve në KOSTT ku aktualisht vazhdon të punoj si Senior Specialist për Zhvillim të Rrjetit dhe Dizajn. “Është inspirim dhe njëkohësisht përgjegjësi kur Rrjeti i Transmetimit çdo vit zgjerohet me ndërtimin e infrastrukturës transmetuese të kapaciteteve të reja gjeneruese: nënstationeve dhe me shtim të linjave transmetuese të reja për të rritur sigurinë dhe besueshmërinë e Rrjetit të Transmetimit, përveç kësaj edhe me rehabilitimin e nënstationeve dhe linjave ekzistuese. Krahasuar me vitet e mëparshme ka një rritje të diversitetit gjinor në sektorë të ndryshëm në kuadër të kompanisë jo vetëm si numër po në bashkëpunim reciprok dhe se duhet vazhduar më tej me analizimin e gjendjes reale brenda kompanisë në mënyrë që të rriten mundësitë e përfshirjes së femrave në marrjen e përgjegjësisë dhe obligimeve në sektorët ku pjesëmarrja është e ulët” u shpreh Shpresa.



**Nexhat Simnica**, ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Krugëtimin në sektorin e energjisë e filloi në vitin 1990 kur edhe u punësua në Ndërmarrjen Punuese Elektroekonomia e Kosovës - Mihja Sipërfaqësore „Kosova” Bellaqevc. Nga viti 2005 ka filluar punën në Divizionin e Bartjes dhe Dispeçingut dhe nga viti 2020 mbanë pozitën e Menaxherit të Sektorit të Planifikimit dhe Kontrollit të Buxhetit në Departamentin e Financave në KOSTT. “KOSTT është një ndërmarrje publike e rëndësishme së veçantë për sektorin e energjisë e cila i ka kushtuar kujdes permanent ngritjes profesionale dhe freskimit me kuadro të reja duke i mbështetur dhe përkrahur në avancimin e njohurive të reja profesionale me anë të trajnimeve, pjesë e të cilave në mënyrë aktive dhe permanente kam qenë edhe unë. Padyshim që kontributi i të dy gjinive luan rol të madh në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Mendoj se KOSTT kësaj çështje i ka kushtuar një kujdes të veçantë duke promovuar vlerat dhe duke ngritur vetëdijen tek punonjësit për rëndësinë e diversitetit gjinor” u shpreh Nexhati.



